

Nr. Prot. 005/B/17**VENDIM Nr. 921**

Për
Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik
të
“Rregullores Teknike për Radio - Pajisje”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 9 paragrafi 3 pika 8), nenit 10, paragrafi 4), neni 79, paragrafi 1) dhe 2), neni 82 dhe nenit 94 i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nenit 20 të Rregullores së Brendshme (*Ref. Nr.Prot.161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- | | |
|----------------------|------------------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar i Bordit |
| 2) z. Nijazi Ademja | Anëtar i Bordit |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar i Bordit |
| 4) z. Bahri Anadolli | Anëtar i Bordit |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar i Bordit |

në mbledhjen e 13-të me radhë të mbajtur më datë 20 Janar 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DRMI, DKE dhe DL, unanimisht morri këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik për “Rregulloren teknike për radio - pajisje”.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **26 Janar 2017** dhe përfundon më datë **25 Shkurt 2017**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Neni 94 i Ligjit përcakton se *“Kushtet dhe kërkesat themelore për lidhje të radio-pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, obligimet që kanë të bëjnë me informatat për specifikat e ndërfaqeve dhe lidhjen me radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, procedurat dhe kushtet për dalje në treg, shitje dhe përdorim të këtyre pajisjeve, procedurat dhe kushtet për testim të konformitetit, aprovimi dhe monitorimi, si dhe kërkesat përgjegjëse duhet të përshkruhen në Rregulloren Teknike për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, të aprovuar nga Autoriteti.”*

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 25/01/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi

Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
- Departamentit të Radio Monitorimit dhe Inspektimit, ARKEP;
- Arkivit, ARKEP